




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 01.03.2017

Ref.: 127/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr.676/16, dt. 17.11.2016 e BPrAL Kolegji "UBT" për akreditim të programeve të studimit:

- Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, PhD, (180 ECTS);
- Ekonomiks dhe Administrim Biznesi, PhD, (180 ECTS).
- Turizëm dhe Menaxhim i Udhëtimeve, BSc (180 ECTS), me specializime: Menaxhimi i Hoteleve; Menaxhimi i Turizmit; Menaxhimi i Iventeve; dhe Menaxhimi i Aktiviteteve;
- EU Përkthim dhe Gjuhët, MA (120 ECTS), me specializime: Përkthyes dhe Interpretues të Gjermanishtës; Përkthyes dhe Interpretues të Anglishtes; dhe Përkthyes dhe Interpretues të Frangjishtës.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "UBT" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit: Turizëm dhe Menaxhim i Udhëtimeve, BSc (180 ECTS) (me specializime: Menaxhimi i Hoteleve; Menaxhimi i Turizmit; Menaxhimi i Iventeve; dhe Menaxhimi i Aktiviteteve); EU Përkthim dhe Gjuhët, MA (120 ECTS), (me specializime në: Përkthyes dhe Interpretues të Gjermanishtës; Përkthyes dhe Interpretues të Anglishtes; dhe Përkthyes dhe Interpretues të Frangjishtës); Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, PhD, (180 ECTS); dhe Ekonomiks dhe Administrim Biznesi, PhD, (180 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "UBT", dhe pas shqyrtimit të dosjeve të stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë

1/2


të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji "UBT" për programet e cekura në dispozitiv.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "UBT", KSHC konstaton se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe të studimit, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit të BPrAL Kolegji "UBT" për programet e cekura më sipër.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:


- BPrAL Kolegji "UBT"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë





4350/45
Shkresë
21/10/2016



Shkresë

Për: Agjencinë e Akreditimit të Kosovës;

Nga: BPrAL Kolegji UBT

Lënda: Faqet e para për aplikim për ri-akreditim

Bashkangjitur me këtë shkresë, ju dërgojmë në formë elektronike dhe fizike Faqet e para për programeve në ri-akreditim si më poshtë:

Nr.	Emri i programit	Specializimi	Niveli i studimeve	Gradën shkencore	ECTS	Numri i studenteve
1	Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment	1. Burimet e Energjisë; 2. Konservimi i Energjisë; 3. Eficenca e Energjisë; 4. Menaxhimi i Energjisë; 5. Inxhinieri Elektrike; 6. Konservimi i Energjisë në Ndërtesa; 7. Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes; 8. Energjia Gjeotermike.	Niveli V	Profesionale	120	50
2	Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment	1. Burimet e Energjisë; 2. Konservimi i Energjisë; 3. Eficenca e Energjisë; 4. Menaxhimi i Energjisë; 5. Inxhinieri Elektrike; 6. Konservimi i Energjisë në Ndërtesa; 7. Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes;	Niveli VI	BSc	180	100



Adresa/ Address: Lagja Kalabria pn; 10000; Prishtinë; Republika e Kosovës

Telefoni/ Phone: 038 541 400; fax: 038 542 138

<http://www.ubt-uni.net>

		8. Energjia Gjeotermike.				
3	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor	1. Arkitektura e Qëndrueshme; 2. Dizajni Interierit; 3. Restaurim; 4. Planifikim Urban.	Niveli VII	MSc	120	400
4	Politika Publike dhe Menaxhim	1. Politika Publike; 2. Menaxhim Publik; 3. E-Qeverisje.	Niveli VII	MA	120	100
5	Sistemet e Informacionit dhe Menaxhment	1. Sistemet e Informacionit Biznesit; 2. Sistemet Hapësinore te Informacionit; 3. Sistemet e Informacionit te Bibliotekave dhe Arkivimit; 4. Statistike, Procesimi i te Dhënave dhe Simulim; 5. Siguria dhe Privatësia e Informacionit; 6. Tregtia Elektronike.	Niveli VII	MSc	120	150

Sekretari i UBT-së

MSc. Artan Tahiri





4964/45
Shkresë
15/11/2016

Shkresë


Për: Agjencinë e Akreditimit të Kosovës;

Nga: BPrAL Kolegji UBT

Lënda: Faqet e para për aplikim për akreditim

Bashkangjitur me këtë shkresë, Ju dërgojmë në formë elektronike dhe fizike Faqet e para për programet në akreditim si më poshtë:

Nr.	Emri i programit	Specializimi	Niveli i studimeve	Gradën shkencore	ECTS	Numri i studenteve	ESAC	Përgjegjësit e programeve
1	Turizëm dhe Menaxhimi i Udhëtimeve	1. Menaxhim i Hoteleve 2. Menaxhim i Turizmit 3. Menaxhim i lventeve 4. Menaxhim i Aktiviteve	Niveli VI	BSc	180	100	04.4	Zilja Zimeri
2	Stomatologji		Niveli VII	Dr. Stom.	360	300	12.4	Fitim Alidemaj
3	Inxhinieri e Qëndrueshme dhe Menaxhiment	1. Energji 2. Ushqim 3. Uji 4. Mjedi 5. Transport 6. Planifikim dhe të dhëna Infrastrukturore	Niveli VII	MSc	60	50	06.9	Elvida Pallaska
4	Farmacit	1. Pskologji dhe Menaxhiment	Niveli VII	Mr. Ph.	300	300	12.5	Shpend Dragusha
5	Mjekësi e përgjithshme		Niveli VII	Dr. Med.	360	300	12.0	Pranvera Ibrahim
6	Shkenca politike		Niveli VII	MA	120	50	14.1	Belul Beqaj
7	Juridik, Kriminologji Kompjuterike dhe Forenzikë		Niveli VII	LLM	60	50	10.0	Skender Gojani



Adresa/ Address: Lagja Kalabria pn; 10000; Prishtinë; Republika e Kosovës
Telefoni/ Phone: 038 541 400; fax. 038 542 138
<http://www.ubt-uni.net>

8	EU Përkthim dhe Gjuhët	1. Përkthyes dhe Interpretues të Gjermanishtes 2. Përkthyes dhe Interpretues të Anglishtes 3. Përkthyes dhe Interpretues të Frëngjishtes	Niveli VII	MA	120	50	09.9	Metush Sylajmani
9	Psikologji dhe Menaxhim	1. Psikologjia e punës dhe Industriale 2. Psikologjia Klinike 3. Psikologjia e Fëmijëve 4. Psikologjia Sociale dhe Edukimi	Niveli VI	BSc	180	300	14.9	Festina Balidemaj
10	Inxhinieri dhe menaxhment	1. Sistemet Inxhinierike dhe Menaxhmenti 2. Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	VIII	PhD	180	20	06.9	Edmond Hajrizi
11	Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor		VIII	PhD	180	20	02	Tomor Elezskurtaj
12	Ekonomiks dhe Administrim Biznesi		VIII	PhD	180	20	12.5	Nehat Ramadani

Sekretari i UBT-së

MSc. Artan Tahiri

